

PËRMBLEDHJA E PULSIT PUBLIK XXIV

PRILL 2023

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë ato të pjesëmarrësve të anketës së opinionit dhe nuk i paraqesin domosdoshmërisht pikëpamjet e UNDP-së apo USAID-it.

PËRMBAJTJA

Lista e tabelave	4
Lista e figurave.....	5
Përmbledhje ekzekutive.....	6
Treguesit kyç të Pulsit Publik.....	8
Drejtimi politik	9
Siguria personale	10
Indekset e Demokratizimit dhe Besueshmërisë Ekonomike.....	11
Drejtimi Ekonomik	14
Problemet madhore me të cilat përballlet Kosova aktualisht	15
Rekrutimi në baza meritore në sektorin publik dhe privat	16
Perceptimet për korrupsionin në shkallë të gjerë	18
Qëndrimet kundrejt votimit.....	20
Mjedisi	23
Drejtësia Tranzicionale	27
Metodologjia	30
Peshimi/Ponderimi i totaleve të popullatës	30
Përlllogaritja e Indekseve.....	32

LISTA E TABELAVE

TABELA 1	Kënaqshmëria e të anketuarve me institucionet kyçe ekzekutive, legjislativë dhe gjyqësore në Kosovë.....	8
TABELA 2	Analiza e trendeve të komponentëve të ID-së.....	13
TABELA 3	Analiza e trendeve të komponentëve të IBE-së.....	13
TABELA 4	Perceptimet për prevalencën e korrupsionit në shkallë të gjerë në institucionet publike dhe ndërkombëtare në Kosovë	19

LISTA E FIGURAVE

FIGURA 1	Kënaqshmëria e të anketuarve me drejtimin politik të Kosovës	9
FIGURA 2	Përçindja e të anketuarve që do t'u bashkoheshin protestave politike	10
FIGURA 3	Perceptimi i të anketuarve për sigurinë.....	11
FIGURA 4	Indekset e Demokratizimit dhe Besueshmërisë Ekonomike	12
FIGURA 5	Kënaqshmëria me drejtimin ekonomik të Kosovës.....	14
FIGURA 6	Perceptimet për problemet madhore me të cilat përballet Kosova aktualisht.....	16
FIGURA 7	Perceptimet për rolin e meritokracisë në arritjen e punësimit në sektorin publik.....	17
FIGURA 8	Perceptimet për rolin e meritokracisë në arritjen e punësimit në sektorin publik kundrejt sektorit privat	18
FIGURA 9	Arsyet e të anketuarve për vlerësimin e tyre mbi shtrirjen e korrupsionit në Kosovë	19
FIGURA 10	Perceptimi i të anketuarve nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë	20
FIGURA 11	Perceptimi i meshkujve dhe femrave nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë	21
FIGURA 12	Perceptimi i komuniteteve të ndryshme nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë	21
FIGURA 13	Gjasat që të anketuarit të votojnë nëse votimet qendrore do të mbaheshin së shpejti	22
FIGURA 14	Gjasat që të anketuarit të votojnë dhe preferencat e votimit, të dhëna të zberthyer sipas përkatësisë etnike.....	23
FIGURA 15	Vetëdijesimi i të anketuarve në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër	23
FIGURA 16	Vetëdijesimi i të anketuarve në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër, të dhëna të zberthyer sipas përkatësisë etnike	24
FIGURA 17	Vetëdijesimi i të anketuarve për kërcënime potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre.....	25
FIGURA 18	Vetëdijesimi i të anketuarve për kërcënime potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre, të dhëna të zberthyer sipas përkatësisë etnike	26
FIGURA 19	Vetëdijesimi i të anketuarve për ndikimin e ndryshimeve klimatike në Kosovë ..	26
FIGURA 20	Vetëdijesimi i të anketuarve për ndikimin e ndryshimeve klimatike në Kosovë, të dhëna të zberthyer sipas përkatësisë etnike.....	27
FIGURA 21	Opinionet e të anketuarve për mbulimin profesional nga media të trashëgimisë së konfliktit dhe të shkuarës kolektive të Kosovës.....	28
FIGURA 22	Perceptimi i të anketuarve mbi ndikimin e Marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve tek populli i Kosovës.....	28
FIGURA 23	Perceptimi i të anketuarve rreth çështjes nëse Marrëveshja për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do ta forcojë kohezionin social në Kosovë, të dhëna të zberthyer sipas gjinisë	29

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Pulsi Publik, një projekt i rëndësishëm kërkimor, i financuar nga USAID-i për më shumë se njëzet vjet, dhe i zbatuar nga UNDP-ja, ka kontribuar drejtpërsëdrejti në ofrimin e të dhënave të besueshme dhe të paanshme për institucionet dhe palët e interesit në Kosovë, si dhe për partnerët ndërkombëtarë në kuadër të përpjekjeve më të gjera për avokim për përdorimin e të dhënave për zhvillimin e politikave, pasi që ato janë kritike si për intervenimet e duhura institucionale ashtu edhe për rritjen e llogaridhënies institucionale.

Si pjesë e projektit, Përmbledhjet e Pulsit Publik i ofrojnë gjetjet për treguesit kyç në lidhje me perceptimin e qytetarëve për çështjet socio-ekonomike, sigurinë, mjedisin dhe çështjet politike. Anketat e opinionit realizohen dy herë në vit dhe e pasqyrojnë opinionin e mbi 1,300 të anketuarve mbi 18 vjeç në Kosovë¹. Gjetjet e raportit të Përmbledhjes së Pulsit Publik XIV bazohen në të dhënat e mbledhura nga 4 deri më 25 prill 2023 në mbarë territorin e Kosovës, me numër të barabartë të meshkujve dhe femrave si dhe me të gjitha grupet etnike që jetojnë në Kosovë. Të dhënat dhe treguesit nga anketat e opinionit zërthehen sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë në mënyrë që të sigurohen informata të detajuara mbi dallimet në perceptimet për sfidat zhvillimore me të cilat përballen qytetarët e Kosovës.

Të dhënat nga anketa e opinionit e prillit 2023 tregojnë se mesatarisht, kënaqshmëria e qytetarëve me institucionet qendrore të Kosovës është rritur për 5.9 pikë përqindje. Kënaqshmëria me performancën e kabinetit ekzekutiv kapi vlerën prej 45.8%, duke shënuar një rritje prej 4.8 pikë përqindjeje krahasuar me nëntorin 2022 kur ishte 41%. Kënaqshmëria me punën e kryeministrit kapi vlerën prej 51.5%, duke treguar rritje për 6.6 pikë përqindje krahasuar me nëntorin 2022 (44.95%). Kënaqshmëria me punën e Kuvendit kapi vlerën prej 46.5%, krahasuar me 39.1% në nëntor 2022, ndërsa kënaqshmëria me kryetarin e Kuvendit të Kosovës ishte 58.3%, krahasuar me 50.8% në nëntor 2022. Niveli i kënaqshmërisë me Presidenten kapi vlerën 60.3%, krahasuar me 56.8% në nëntor 2022. Ka pasur rritje në shkallën e kënaqshmërisë me Gjykatat dhe Zyrën e Kryeprokurorit, duke kapur vlerën prej 29% për të dyja institucionet, krahasuar me 24.4% dhe 22% përkatësisht, në nëntor 2022.

Kënaqshmëria me drejtimin ekonomik kapi vlerën prej 17.79%, duke u rritur për 6.97 pikë përqindje krahasuar me nëntorin 2022 kur ishte 10.82%.

Indeksi i Demokratizimit (ID) u ul për 0.04 pikë (1.48) krahasuar me nëntorin 2022 kur kjo vlerë ishte 1.52 pikë. Megjithatë, u shënuar rritje për 0.17 në Indeks të Besueshmërisë Ekonomike (IBE), i cili kapi vlerën prej 1.03, krahasuar me 0.86 në nëntor 2022. Si ID-ja ashtu edhe IBE-ja maten në një shkallë nga 0 pikë (minimumi) në 3 pikë (maksimumi), ku vlerat nën 1.5 konsiderohen negative, ndërsa ato mbi 1.5 tregojnë qëndrim pozitiv të shumicës së qytetarëve në lidhje me indekset e demokratizimit dhe ekonomisë.

Një numër dukshëm më i lartë i të anketuarve ishin të gatshëm të protestonin për arsye politike në prill 2023 krahasuar me nëntorin 2022 (24.2%). Ky numër përputhet me numrin e qytetarëve që ishin gati të protestonin për arsye politike në prill 2022. Të dhënat e zber-

¹ Për UNDP-në, referencat për Kosovën do të kuptohen në kontekstin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999).

thyerë sipas përkatësisë etnike treguan se një numër më i madh i serbëve të Kosovës (40.5%) ishin të gatshëm të protestonin për arsye politike në krahasim me shqiptarët e Kosovës (28.5%) dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (29.5%).

Gjetjet nga anketa e opinionit e prillit 2023 tregojnë rritje të lehtë për sa i përket ndjenjës së sigurisë tek të anketuarit krahasuar me nëntorin 2022, me 82.85% që ndihen të sigurt kur janë jashtë në prill 2023, krahasuar me 80.43% në nëntor 2022. Të dhënat e zbërthyerë sipas gjinisë treguan se më shumë meshkuj (24.9%) sesa femra (21.1%) deklaruan se ndihen të sigurt kur janë jashtë. Ndjenja e sigurisë në mesin e serbëve të Kosovës është rritur (33.8%) në prill 2023, krahasuar me 15.3% në nëntor 2022.

Kur u pyetën për problemet e natyrës më urgjente në Kosovë, papunësia (32.7%), varfëria (20.1%) dhe inflacioni (11.6%) u renditën si tre çështjet kryesore nga të anketuarit. Teksa gjetjet treguan ngjashmëri me problemin më madhor të perceptuar në nëntor 2022, kur papunësia ishte 29.9% dhe varfëria në 21%, ka një rënie në numrin e qytetarëve (17.4%) që renditën çmimet për furnizimet esenciale si problem madhor në nëntor 2022, krahasuar me prillin 2023 (10.2%). Të dhënat e zbërthyerë sipas përkatësisë etnike treguan se marrëdhëniet ndëretnike (20.5%), papunësia (20.5%) dhe infrastruktura rrugore (14.8%) janë perceptuar si tre problemet madhore për serbët e Kosovës, ndërsa papunësia (28%), varfëria (19.5%) dhe ekonomia informale (12%) ishin çështjet e natyrës më urgjente për pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës. Për shqiptarët e Kosovës, papunësia (32.8%), varfëria (20.4%) dhe inflacioni i çmimeve (12.3%) ishin tre problemet madhore në Kosovë.

Të dhënat e Pulsit Publik XXIV kanë shënuar rënie të numrit të të anketuarve që perceptojnë se punësimi në institucionet publike të Kosovës bëhet në baza meritore. Vetëm 22% e të anketuarve besojnë se punësimi në institucionet publike bëhet në baza meritore në prill 2023, krahasuar me 27% në nëntor 2022.

Në këtë edicion, Pulsu Publik u kërkoi të anketuarve t'u përgjigjen pyetjeve rreth drejtësisë tranzicionale. Të dhënat treguan se 58.4% e shqiptarëve të Kosovës dhe 70% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës besojnë plotësisht ose besojnë se Marrëveshja për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të ndikojë pozitivisht në jetën e popullit të Kosovës, ndërsa vetëm 24.8% e serbëve të Kosovës e besojnë të njëjtën gjë. Shumica e të anketuarve (57.1%) besojnë plotësisht ose besojnë se Marrëveshja për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve do ta ndihmojë Kosovën në rrugën e saj drejt BE-së. Të dhënat e zbërthyerë sipas përkatësisë etnike treguan se teksa 58% dhe e shqiptarëve të Kosovës dhe 65% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës besonin ose besonin plotësisht se marrëveshja do ta ndihmonte Kosovën në rrugën e saj drejt BE-së, vetëm 21.6% e serbëve të Kosovës e besonin të njëjtën gjë.

Të dhënat shtesë të marra përmes kësaj ankete do të bëhen të disponueshme përmes Platformës për Vizualizimin e të Dhënave të Pulsit Publik dhe ASKData.²

² Platforma për Vizualizimin e të Dhënave: <https://app.powerbi.com/view?r=eyJrjoiNTUzMjZjAtNmZlMC00NmQ2LTg3YjAtNmZmOWY2MTNiMTBliwidCl6lmizZTVkYjVlTl5NDQtdGzNy05OWYlTc0ODhhY2UINDMxOSlsmMiOjh9> ASKData është një platformë e Agjencisë së Statistikave të Kosovës: <https://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/sq/askdata/>.

TREGUESIT KYÇ TË PULSIT PUBLIK

Të dhënat e anketës së opinionit të prillit 2023 treguan një rritje pozitive të kënaqshmërisë së të anketuarve me punën e të gjitha institucioneve qendrore të Kosovës. Mesatarisht 45.8% e të anketuarve ishin të kënaqur me punën e institucioneve qendrore të Kosovës krahasuar me 39.9% në nëntor 2022, 48.4% në prill 2022, 47% në nëntor 2021, 51.4% në prill 2021.

Të dhënat nga anketa e opinionit e prillit 2023 tregojnë se mesatarisht, kënaqshmëria e qytetarëve me institucionet qendrore të Kosovës është rritur për 5.9 pikë përqindje. Kënaqshmëria me performancën e kabinetit ekzekutiv kapi vlerën prej 45.8%, duke shënuar një rritje prej 4.8 pikë përqindje krahasuar me nëntorin 2022 kur ishte 41%. Kënaqshmëria me punën e kryeministrit kapi vlerën prej 51.5%, duke treguar rritje për 6.6 pikë përqindje krahasuar me nëntorin 2022 (44.95%). Kënaqshmëria me punën e Kuvendit kapi vlerën prej 46.5%, krahasuar me 39.1% në nëntor 2022, ndërsa kënaqshmëria me kryetarin e Kuvendit të Kosovës ishte 58.3%, krahasuar me 50.8% në nëntor 2022. Niveli i kënaqshmërisë me Presidenten kapi vlerën 60.3%, krahasuar me 56.8% në nëntor 2022. Ka pasur rritje në shkallën e kënaqshmërisë me Gjykatat dhe Zyrën e Kryeprokurorit, duke kapur vlerën prej 29% për të dyja institucionet, krahasuar me 24.4% dhe 22% përkatësisht, në nëntor 2022.

Treguesit politikë		Maj-19	Nën-19	Prill-20	Dhje-20	Maj-21	Nën-21	Prill-22	Nën-22	Prill-23	Trendi
Kënaqshmëria me kabinetin ekzekutiv	Kabineti Ekzekutiv	17.70%	14.40%	60.70%	21.30%	59.10%	47.60%	47.20%	41.00%	45.80%	
	Kryeministri	36.50%	20.70%	65.40%	23.00%	59.50%	53.20%	52.60%	44.90%	51.50%	
Kënaqshmëria me legjislativin	Kuvendi	19.60%	18.60%	33.40%	22.60%	52.90%	50.30%	50.20%	39.10%	46.40%	
	Kryetari i Kuvendit	23.60%	20.50%	72.40%	46.70%	59.20%	55.40%	54.40%	50.80%	58.30%	
Kënaqshmëria me Presidenten	Presidentja	20.40%	21.20%	18.70%	33.90%	63.70%	55.20%	58.40%	56.80%	60.30%	
Kënaqshmëria me gjyqësorin	Gjykata	18.70%	13.60%	24.80%	23.00%	34.60%	33.90%	39.10%	24.40%	29.00%	
	Prokuroria	16.40%	14.20%	22.30%	23.00%	30.80%	34.00%	37.10%	22.00%	29.00%	

TABELA 1 Kënaqshmëria e të anketuarve me institucionet kyçe ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore në Kosovë

DREJTIMI POLITIK

Rritja e kënaqshmërisë me institucionet kyçe qendrore nuk u pasua me rritje në aspektin e drejtimit politik. Krahasuar me nëntorin e vitit 2022 (23.62%), afërsisht i njëjti numër i të anketuarve (23.2%), ishin shumë të kënaqur dhe të kënaqur me drejtimin politik të Kosovës. Rreth një e treta e të anketuarve (31.2%) ishin neutralë dhe 45.6% ishin të pakënaqur me drejtimin politik të Kosovës.

Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë tregojnë dallime shumë të vogla mes meshkujve dhe femrave sa i përket kënaqshmërisë me drejtimin politik të Kosovës, ku 22.8% e femrave dhe 23.5% e meshkujve janë shumë të kënaqur dhe të kënaqur me drejtimin politik të Kosovës. Më shumë meshkuj (49.2%) sesa femra (41.7%) ishin të pakënaqur me drejtimin politik të Kosovës. Dallime më të mëdha janë shënuar në të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike, ku niveli i kënaqshmërisë me drejtimin politik të Kosovës në mesin e komuniteteve të tjera të Kosovës ishte më i larti me 44%, ndjekur nga shqiptarët e Kosovës me 22.1% dhe serbët e Kosovës me 6.2%. Vlen të theksohet se niveli i kënaqshmërisë së serbëve të Kosovës është rritur për 4.3 pikë përqindje krahasuar me nëntorin 2022, kur ky numër ishte 1.9%. Sidoqoftë, niveli më i lartë i pakënaqësisë gjendet tek serbët e Kosovës (52.4%), ndjekur nga shqiptarët e Kosovës (46.2%) dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (23.5%). Përqindja e atyre që janë neutralë në vlerësimin e tyre për drejtimin politik të Kosovës ishte gjithashtu më e larta mes serbëve të Kosovës (41.4%), ndjekur nga komunitetet e tjera të Kosovës (32,5%) dhe shqiptarët e Kosovës (31.1%).




FIGURA 1 Kënaqshmëria e të anketuarve me drejtimin politik të Kosovës

Një numër dukshëm më i lartë i të anketuarve ishin të gatshëm të protestonin për arsye politike në prill 2023 (37.6%), krahasuar me nëntorin 2022 (24.2%). I njëjti numër i qytetarëve të gatshëm për të protestuar u regjistrua në prill 2022 (37.6%). Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike treguan një rritje të gatishmërisë për të protestuar për arsye politike në mesin e të gjitha etnive. Rritja më e madhe e gatishmërisë për të protestuar ishte te serbët e Kosovës me 40.5%, krahasuar me 11% në nëntor 2022. Vlerësimi në mesin e shqiptarëve të Kosovës ishte 28.5% krahasuar me 24.3% në nëntor 2022, ndërsa vlerësimi në mesin e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës ishte 29.5% krahasuar me 21% në nëntor 2022.




FIGURA 2 Përqindja e të anketuarve që do t'u bashkoheshin protestave politike

SIGURIA PERSONALE

Për ta matur perceptimin për sigurinë personale në mjedise publike, të anketuarit u pyetën nëse ndihen të sigurt apo të pasigurt kur janë jashtë në rrugë në aspektin e dhunës dhe krimit potencial. Gjetjet e prillit 2023 treguan rritje për 2.42 pikë përqindje në perceptimin e të anketuarve për sigurinë e tyre jashtë, krahasuar me nëntorin 2023, përkatësisht 82.85% nga 80.43%.




FIGURA 3 Perceptimi i të anketuarve për sigurinë

Të dhënat e zërthyera sipas gjinisë treguan se meshkujt (83.9%) ndihen më të sigurt kur janë jashtë sesa femrat (81.7%). Gjithsej 85% e shqiptarëve të Kosovës dhe 88% e komuniteteve të tjera të Kosovës raportuan se ndihen të sigurt kur janë në rrugë, krahasuar me 33.8% të serbëve të Kosovës. Të dhënat e zërthyera sipas përkatësisë etnike treguan se në përgjithësi, ka një rritje të perceptimit të sigurisë tek të gjitha komunitetet. Krahasuar me nëntorin e vitit 2022, në lidhje me perceptimin e të anketuarve për sigurinë kur janë në rrugë u shënuar rritje për 2.2 pikë përqindje te shqiptarët e Kosovës, rritje për 18.61 pikë përqindje te serbët e Kosovës dhe rritje për 8.5 pikë përqindje te komunitetet tjera të Kosovës.

INDEKSET E DEMOKRATIZIMIT DHE BESUESHMËRISË EKONOMIKE

Anketa e opinionit e Pulsit Publik e majit 2023 shënoi ulje në Indeksin e Demokratizimit dhe rritje në Indeksin e Besueshmërisë Ekonomike. Më konkretisht ID-ja aktuale është ulur për 0.04 pikë (1.48) krahasuar me nëntorin 2022 (1.52). Indeksi i Besueshmërisë Ekonomike është rritur për 0.17 pikë (1.03) krahasuar me nëntorin 2022 (1.03).




FIGURA 4 *Indekset e Demokratizimit dhe Besueshmërisë Ekonomike*

Si ID-ja ashtu edhe IBE-ja janë të përbëra nga një numër komponentësh që përdoren për t'i gjeneruar indekset përkatëse. ID-ja përbëhet nga nëntë komponentë të paraqitur në Tabelën 2 më poshtë. Pyetjet për këtë indeks mund të përgjigjen me "Po, plotësisht", "Po, kryesisht", "Jo aq shumë", ose "Aspak". Tabela 2 e tregon përqindjen e të anketuarve që u përgjigjën me "Po, plotësisht" ose "Po, kryesisht" në nëntë pyetjet. Për të përcaktuar se cilët tregues ndikuan në uljen e ID-së, të dhënat nga anketa e opinionit e nëntorit 2022 u krahasuan me ato të gjeneruara në anketat e mëparshme. Të dhënat treguan se gjithsej 62.2% e të anketuarve pohuan se zgjedhjet në Kosovë janë demokratike dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare, krahasuar me 69% në nëntor 2022, 73% në prill 2022 dhe 70.9% në nëntor 2021. Numri i të anketuarve që besonin se Kuvendi e monitoron punën e Kabinetit Ekzekutiv ishte 51.3%, krahasuar me 61% në nëntor 2022 dhe 67.5% në prill 2022. Gjetjet treguan një rënie të perceptimit të të anketuarve se sistemi gjyqësor është i parvarur në vendimet e tij, me 29.2% krahasuar me 34.5% në nëntor 2022. Në anketën e opinionit të majit 2023 është shënuar rënie në besimin se kabineti ekzekutiv i Kosovës dhe në besimin se institucionet lokale punojnë sipas prioriteteve të qytetarëve të Kosovës. Teksa vlerë e parë pati një rënie nga 44.5% në nëntor 2022 në 40.6% në maj 2023, e dyta ra nga 51.4% në nëntor 2022 në 46.7% në maj 2023. Në fund, është vërejtur një rënie për 3.5 pikë përqindje në opinionin e të anketuarve se proceset demokratike në Kosovë po shkojnë në drejtimin e duhur.

A janë zgjedhjet në Kosovë demokratike dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare?	35.60%	62.73%	66.30%	45.87%	70.44%	70.88%	73.42%	69.02%	62.20%	
A e monitoron Kuvendi performancën e kabinetit ekzekutiv?	38.10%	38.61%	58.00%	45.56%	60.13%	62.95%	67.47%	61.00%	51.30%	
A është sistemi i gjyqësorit në Kosovë i pavarur në vendimet e tij?	21.50%	31.48%	39.70%	36.66%	37.50%	44.88%	41.67%	34.49%	29.20%	
A gëzon media në Kosovë lirinë e shprehjes?	45.60%	46.66%	69.10%	57.94%	69.24%	60.70%	69.60%	62.02%	63.70%	
A shërben Shoqëria Civile në Kosovë si monitorues i sinqertë i zhvillimeve demokratike në Kosovë?	32.60%	34.79%	50.70%	45.77%	56.56%	55.62%	61.89%	49.83%	51.30%	
A funksionon qeverisja juaj lokale (komunale) sipas prioriteteve të qytetarëve të Kosovës?	29.80%	29.62%	56.70%	41.53%	52.64%	54.88%	55.82%	51.38%	46.70%	
A punon kabineti qendror ekzekutiv i Kosovës sipas prioriteteve të qytetarëve të Kosovës?	18.10%	24.23%	54.90%	30.61%	54.39%	49.28%	56.78%	44.51%	40.60%	
A janë demokratike kushtetuta e Kosovës dhe ligjet në fuqi dhe a i respektojnë të drejtat e njeriut?	33.40%	40.30%	64.00%	42.82%	58.07%	59.49%	63.05%	59.07%	60.30%	
Pavarësisht nga politika e përditshme dhe me vështrimin drejt të ardhmes, a pranoi se proceset demokratike në Kosovë janë vendosur dhe po shkojnë në drejtimin e duhur?	22.40%	33.01%	42.50%	36.22%	58.65%	55.65%	59.63%	51.00%	47.50%	

TABELA 2 Analiza e trendeve të komponentëve të ID-së

Për të përcaktuar se cilët tregues ndikuan në uljen e IBE-së, përgjigjet aktuale pozitive për komponentët e IBE-së u krahasuan me ato të mbledhura në anketat e mëparshme të opinionit, siç tregohet në Tabelën 3 më poshtë. Përgjigjet e mundshme për pyetjet që kanë të bëjnë me IBE-në janë “të favorshme”, “jo të favorshme” dhe “neutrale”. Gjithsej 14% e të anketuarve kishin pritshmëri të favorshme për të hyrat totale të familjes së tyre brenda gjashtë muajve të ardhshëm, duke u rritur për 3.1 pikë përqindje krahasuar me nëntorin 2022 (11.2%). Gjithsej 8.4% e të anketuarve pohuan vlerësime të favorshme për kushtet aktuale të biznesit. Rritje e lehtë krahasuar me nëntorin 2022 (7.1%) vërehet në perceptimet e të anketuarve për kushtet aktuale të punësimit, ku 8.2% i konsiderojnë si të favorshme. Në fund, vërehet një rritje deri diku më e lartë në mënyrën se si i shohin të anketuarit kushtet e ardhshme të punësimit - gjashtë muaj nga anketa e opinionit e majit 2023 - gjithsej 12.6% i shohin si të favorshme, krahasuar me 8.3% në nëntor 2022. Si përmbledhje, përgjigjet në komponentët e IBE-së sugjerojnë se më pak se gjysma e qytetarëve të Kosovës (1.03) kanë pikëpamje optimiste për ekonominë.

Të favorshme	Maj-19	Nën-19	Prill-20	20-Dhje	Maj-21	Nën-21	Prill-22	Tet-22	Prill-23	Trend
Cilat janë pritshmëritë tuaja në lidhje me të ardhurat totale të familjes suaj gjashtë muaj nga sot?	11.60%	13.70%	14.20%	11.50%	15.90%	15.90%	17.20%	11.20%	14.30%	
Cili është vlerësimi juaj i kushteve aktuale të biznesit?	5.50%	9.10%	8.20%	7.20%	4.70%	12.80%	7.30%	8.20%	8.40%	
Cili është vlerësimi juaj për kushtet aktuale të punësimit?	5.80%	7.40%	6.60%	5.60%	7.00%	10.80%	6.30%	7.10%	8.20%	
Cilat janë pritshmëritë tuaja në lidhje me kushtet e punësimit gjashtë muaj nga sot?	4.60%	12.00%	11.60%	8.30%	18.80%	15.90%	10.50%	8.30%	12.60%	

TABELA 3 Analiza e trendeve të komponentëve të IBE-së

DREJTIMI EKONOMIK

Në përputhje me rritjen e Indeksit Ekonomik, u shënuar rritje pozitive në aspektin e perceptimit për drejtimin aktual ekonomik të Kosovës. Gjetjet nga anketa e opinionit publik e prillit 2023 treguan rritje për 7 pikë përqindje të kënaqshmërisë me drejtimin ekonomik krahasuar me nëntorin 2022, kur ky numër ishte 10.82%. Megjithatë, numri i të anketuarve që ishin të pakënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës mbeti i lartë, me 57.29% shumë të pakënaqur ose të pakënaqur me drejtimin ekonomik. Teksa 18.5% e meshkujve janë shumë të kënaqur ose të kënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës, vetëm 16.7% e femrave ndihen njësoj. Përafërsisht i njëjti numër i meshkujve (57.5%) dhe i femrave (57%) ishin shumë të pakënaqur ose të pakënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës. Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike treguan se shqiptarët e Kosovës renditen me nivelin më të lartë të pakënaqësisë me 57.9%, të ndjekur nga serbët e Kosovës me 56.6% dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës me 39.6%. Krahasuar me nëntorin 2022, pakënaqësia me drejtimin ekonomik të serbët e Kosovës është rritur për 9.5 pikë përqindje, por është ulur te pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës për 9.9 pikë përqindje.




FIGURA 5 Kënaqshmëria me drejtimin ekonomik të Kosovës

PROBLEMET MADHORE ME TË CILAT PËRBALLET KOSOVA AKTUALISHT

Të anketuarve iu kërkua që të shkruajnë për problemin e natyrës më urgjente me të cilin përballet aktualisht Kosova, dhe papunësia (32.7%), varfëria (20.1%) dhe inflacioni (11.6%) janë identifikuar si tre problemet madhore të natyrës më urgjente në Kosovë. Çmimet për furnizimet esenciale (10.2%) dhe shërbimet e kujdesit shëndetësor (4.7%) ishin ndër pesë problemet kryesore të identifikuara. Krahasuar me anketën e nëntorit 2022, numri i atyre që e kanë renditur papunësinë si problem madhor është rritur për 2.8 pikë përqindje, ndërsa numri i atyre që i kanë renditur çmimet për furnizimet esenciale si problem madhor është ulur për 7.2 pikë përqindje.

Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë treguan se ashtu si në anketat e mëparshme, femrat (37.7%) ishin më të shqetësuara për papunësinë krahasuar me meshkujt (27.8%). Megjithatë, ndryshe nga anketa e opinionit e nëntorit 2022, ku femrat (20.6%) dhe meshkujt (21.2%) dukej se ishin njëloj të shqetësuar për varfërinë, të dhënat e prillit 2023 treguan se femrat (22.1%) ishin më të shqetësuara për varfërinë sesa meshkujt (18.1%).

Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike treguan se papunësia renditet si problemi kryesor për të gjitha etnitë, përkatësisht për 32.8% të shqiptarëve të Kosovës, 28% të pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës dhe 20.5% të serbëve të Kosovës. Teksa varfëria u rendit si çështja e dytë e natyrës më urgjente nga 20.4% e shqiptarëve të Kosovës dhe 19.5% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, infrastruktura rru-gore u rendit si çështja e dytë e natyrës më urgjente nga 14.8% e serbëve të Kosovës.




FIGURA 6 Perceptimet për problemet madhore me të cilat përballet Kosova aktualisht

REKRUTIMI NË BAZA MERITORE NË SEKTORIN PUBLIK DHE PRIVAT

Anketa e opinionit e prillit 2023 tregoi rënie për pesë pikë përqindje në perceptimin e të anketuarve për punësimin në baza meritore në sektorin publik. Teksa në nëntor 2022, 27% e të anketuarve besonin se punësimi në sektorin publik bëhet në baza meritore, vetëm 22% e mendonin të njëjtën gjë në prill 2023. Kur u pyetën se çfarë është më e rëndësishme për punësimin në sektorin publik, të anketuarit e renditën përkatësinë partiake (33.9%) dhe lidhjet familjare (28%) si dy përgjigjet kryesore, ndjekur nga arsimimi (15.4%), ryshfeti (11%), përvoja profesionale (3.8%), trajnimet profesionale (3%) dhe miqtë (3%).

Ndryshe nga anketa e opinionit e nëntorit 2022, kur femrat kishin më shumë besim sesa meshkujt në punësimin në baza meritore, të dhënat e prillit 2023 treguan se më shumë meshkuj (24.1%) besonin se punësimi në sektorin publik bëhet në baza meritore, krahasuar me femrat (20.5%). Si për meshkujt ashtu edhe për femrat, përkatësia partiake ishte mënyra më e dobishme për ta gjetur një vend pune në sektorin publik, me përkatësisht 37% dhe 30.7%.

Ngjashëm me anketat e mëparshme, të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë se lidhjet partiake duket se janë faktori kyç për sigurimin e punësimit për shqiptarët e Kosovës (35.1%) dhe serbët e Kosovës (23.1%), kurse për komunitetet tjera të Kosovës është arsimimi (23.5%) që e mundëson punësimin në sektorin publik. Teksa në katër anketat e mëparshme (prill 2021, nëntor 2021, prill 2022 dhe nëntor 2022), besimi më i ulët në punësimin në baza meritore u konstatua në mesin e serbëve të Kosovës, në anketën e opinionit të prillit 2023 besimi më i vogël në punësimin në baza meritore në sektorin publik u konstatua në mesin e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës (39.2%), ndjekur nga serbët e Kosovës (36.5%) dhe shqiptarët e Kosovës (20.9%).




FIGURA 7 Perceptimet për rolin e meritokracisë në arritjen e punësimit në sektorin publik

Sa i përket sektorit privat, 54% e të anketuarve besojnë se punësimi në sektorin privat fitohet sipas kriterëve në baza meritore. Përvoja profesionale perceptohet si kriteri më i dobishëm për punësimin në sektorin privat nga 35.2% e të anketuarve. Të anketuarit i identifikuan faktorët e mëposhtëm jo meritore për të siguruar punësim në sektorin privat: lidhjet familjare (19.2%), miqtë (16.9%), përkatësia partiake (4.1%), ryshfeti (2.9%), paraqitja e jashtme (2.2%) dhe, në masë më të vogël, gjinia (0.6%).

Ashtu si në anketën e opinionit të nëntorit 2022, kur meshkujt (54.5%) ishin më të sigurt në punësimin në baza meritore në sektorin privat sesa femrat (51.6%), në anketën e opinionit të prillit 2023, më shumë meshkuj (56%) raportuan se ishin të sigurt në punësimin në baza meritore në sektorin privat, sesa femrat (51.4%).

Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike treguan se serbët e Kosovës (63.3%) ishin më të sigurt në punësimin në sektorin privat, sesa pjesëtarët e komuniteteve tjera të Kosovës (56.5%) dhe shqiptarët e Kosovës (52.7%).




FIGURA 8 Perceptimet për rolin e meritokracisë në arritjen e punësimit në sektorin publik kundrejt sektorit privat

PERCEPTIMET PËR KORRUPSIONIN NË SHKALLË TË GJERË

Mesatarisht, 23.5% e anketuarve pohuan se e perceptojnë që korrupsioni në shkallë të gjerë është i pranishëm në institucionet publike dhe ndërkombëtare në Kosovë, krahasuar me 21.1% në nëntor 2022 dhe 22.1% në prill 2022. Teksa ky numër ishte në rënie të vazhdueshme që nga dhjetori 2020, kur mesatarisht 28% e të anketuarve pohuan se e perceptonin që korrupsioni në shkallë të gjerë është i pranishëm, në prill 2023 u shënuar një rritje për 2.4 përqind krahasuar me nëntorin 2022.

Policia e Kosovës është perceptuar si më së paku e korruptuar me 7.3% që besojnë se ka prani të korrupsionit në shkallë të gjerë, ndjekur nga Organizatat Ndërkombëtare (14.1%), Komunitat (15.8%), Arsimi (16.9%). Organizatat më të korruptuara janë perceptuar të jenë gjykatat (37.7%), ndjekur nga Dogana (35.8%) dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit (33.7%). Ndryshimet më të mëdha në perceptimet për korrupsionin në shkallë të gjerë janë vërejtur në institucionet e mëposhtme: Dogana (26.9% krahasuar me 35.8% në nëntor 2022), Gjykatat (37.7% krahasuar me 30.8% në nëntor 2022) dhe Administrata Qendrore (25.3% krahasuar me 20.1% në nëntor 2022). Një rënie pozitive e perceptimit për korrupsionin në shkallë të gjerë është vërejtur në lidhje me Policinë e Kosovës (7.3% krahasuar me 13.5% në nëntor 2022), dhe komunitet (15.8% krahasuar me 18.4% në nëntor 2022).

	Maj-19	Maj-19	Prill-20	Dhje-20	Maj-21	Prill-21	Prill-22	Nën-22	Prill-23	Trend
Shëndetësia (spit-alet dhe qendrat e mjekësisë familjare)	25.10%	33.40%	11%	25%	22.90%	18.80%	18.10%	18.60%	20.50%	
KEDS	40.70%	38.90%	27.30%	28.70%	26.10%	25.80%	26.50%	24.50%	28.40%	
KEK				27.50%	25.30%	25.80%	26.70%	23.00%	26.10%	
Gjykatat	30.70%	42.00%	24.50%	31.60%	32.50%	27.70%	27.90%	30.80%	37.70%	
Doganat	29.30%	41.40%	30.60%	39.20%	34.30%	32.30%	36.20%	26.90%	35.80%	
Administrata qendrore/qeveria	36.70%	35.30%	20.80%	29.50%	23.10%	19.50%	13.90%	20.10%	25.30%	
AKP (Agjencia Kosovare e Privatizimit)	40.70%	48.10%	36.60%	39.00%	39.30%	29.40%	32.60%	28.80%	33.70%	
Komunat (qeverisja lokale)	25.80%	29.80%	13.30%	24.70%	20.40%	19.10%	16.30%	18.40%	15.80%	
Arsimi (shkollat, Universiteti)	20.70%	26.10%	13.60%	19.50%	15.10%	16.80%	12.10%	14.30%	16.90%	
ATK (Administrata Tatimore e Kosovës)	35.30%	42.20%	18.90%	30.20%	27.40%	28.80%	25.40%	24.10%	21.20%	
PTK	44.20%	40.80%	37.90%	33.20%	31.60%	23.70%	25.90%	25.30%	25.40%	
Bankat	33.80%	34.10%	18.90%	28.10%	22.90%	22.20%	20.50%	14.70%	20.70%	
Organizatrat ndërkombëtare	19.50%	23.60%	5.50%	23.80%	15.70%	17.60%	14.00%	12.20%	14.10%	
Policia e Kosovës (PK)	17.00%	20.70%	9.80%	15.30%	14.00%	20.50%	14.00%	13.50%	7.30%	

TABELA 4 Perceptimet për prevalencën e korrupsionit në shkallë të gjerë në institucionet publike dhe ndërkombëtare në Kosovë

Kur u pyetën për arsyet e vlerësimit mbi prezencën e korrupsionit në shkallë të gjerë në institucionet publike dhe ndërkombëtare në Kosovë, në mënyrë të ngjashme me anketat e mëparshme të dhënat treguan se informacioni përmes mediave është përgjigjja kryesore për 68.9% të të anketuarve. Gjithsej 28.6% e të anketuarve deklaruan se bisedat me të afërmit dhe miqtë formojnë bazën e opinioneve të tyre në lidhje me shtrirjen e korrupsionit, ndërsa vetëm 2.6% e të anketuarve pohuan se në opinionet e tyre kanë ndikuar përvojat personale kur atyre iu janë kërkuar para, dhurata ose favore të tjera në këmbim të shërbimeve të caktuara.




FIGURA 9 Arsyet e të anketuarve mbi vlerësimin e tyre për shtrirjen e korrupsionit në Kosovë

QËNDRIMET KUNDREJT VOTIMIT

Anketa e opinionit e Pulsit Publik e prillit 2023 hulumtoi edhe qëndrimet e qytetarëve të Kosovës ndaj votimit. Gjithsej 32.7% e të anketuarve kanë treguar besim se vota e tyre mund ta ndryshojë situatën politike në Kosovë krahasuar me 31.2% në nëntor 2022, 38.1% në prill 2022, 29.4% në vjeshtë 2021 dhe 43.8% në prill 2021. Teksa 33.9% konsiderojnë se vota e tyre nuk mund ta ndryshojë situatën politike, 29.7% mendojnë se e ndryshon deri diku. Gjithsej 3.7% deklaruan se nuk e dinin nëse vota e tyre mund të ndikojë në ndryshim.




FIGURA 10 Perceptimi i të anketuarve nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë

Të dhënat e zberthyera sipas gjinisë treguan rritje të besimit në lidhje me fuqinë e votës së tyre për të ndikuar në ndryshime mes meshkujve krahasuar me nëntorin 2022. Ndërkohë që 34.7% (32% në prill 2022) e meshkujve konsiderojnë se vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë, 30.7% (35.9% në prill 2022) e femrave e mendojnë të njëjtën gjë. Gjithsej 33% e meshkujve dhe 34.9% e femrave besojnë se vota e tyre nuk mund të sjellë ndryshime, ndërsa 29.1% e meshkujve dhe 29.5% e femrave mendojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshime deri diku.




FIGURA 11 Perceptimi i meshkujve dhe femrave nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë

Të dhënat e zërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë rritje ndërmjet komuniteteve në Kosovë në besimin e tyre tek zgjedhjet si mekanizëm për ndryshim. Gjithsej 35% e shqiptarëve të Kosovës konsiderojnë se vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë (33.3% në nëntor 2022), pasuar nga 17.5% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës (12% në nëntor 2022) dhe 3.8% e serbëve të Kosovës (1% në nëntor 2022). Teksa 56.2% e serbëve të Kosovës nuk besojnë se vota e tyre mund të ndikojë në ndryshim (44.8% në nëntor 2022), 51.5% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës dhe 32.4% e shqiptarëve të Kosovës e deklaruan të njëjtën gjë.




FIGURA 12 Perceptimi i komuniteteve të ndryshme nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë

Anketa e Pulsit Publik e prillit 2023 hulumtoi edhe për gjasat që të anketuarit të votojnë nëse zgjedhjet qendrore do të mbaheshin së shpejti, si dhe preferencat e tyre për votim. Të dhënat treguan një rritje të gjasave për të votuar në mesin e të anketuarve. Gjithsej 77.6% e të anketuarve pohuan se do të votonin për një parti apo koalicion të caktuar nëse zgjedhjet qendrore do të mbaheshin së shpejti, krahasuar me 69% në prill 2022, megjithatë ky numër ishte identik me atë të prillit 2022, kur ky numër u regjistrua në vlerën prej 76.5%. Gjithsej 11.4% e të anketuarve deklaruan se nuk do të votonin nëse zgjedhjet qendrore do të mbaheshin së shpejti, ngjashëm me 11.9% në nëntor 2022 dhe 11.1% në prill 2022.




FIGURA 13 Gjasat që të anketuarit të votojnë nëse votimet qendrore do të mbaheshin së shpejti

Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë treguan rritje të gjasave për të votuar si te meshkujt ashtu edhe te femrat. Gjithsej 89.6% e meshkujve thanë se do të votonin nëse zgjedhjet qendrore do të mbaheshin së shpejti, krahasuar me 70.6% në nëntor 2022, dhe 86.8% e femrave thanë se do të votonin nëse zgjedhjet qendrore do të mbaheshin së shpejti, krahasuar me 67.6% në nëntor 2022. Numër identik i meshkujve (10.8%) dhe i femrave (10.7%) thanë se nuk kanë preferenca politike, ndërsa më shumë femra (13.1%) sesa meshkuj (10.1%) pohuan se do të votonin nëse zgjedhjet qendrore do të mbaheshin së shpejti.

Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë se pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (83.3%) dhe serbët e Kosovës (81.4%) kanë më shumë gjasa të votojnë sesa shqiptarët e Kosovës (77.2%) nëse zgjedhjet do të mbaheshin në të ardhmen e afërt. Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike të regjistruara në prill 2023, treguan rritje të gjasave për të votuar në të gjitha etnitë krahasuar me nëntorin 2022, kur këto shifra ishin përkatësisht 71% e serbëve të Kosovës, 74% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës dhe 68.6% e shqiptarëve të Kosovës. Megjithatë, një pjesë më e madhe e të anketuarve serbë të Kosovës (17.5%) deklaruan se nuk do të votonin, krahasuar me shqiptarët e Kosovës (11.5%) dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (7.6%). Më shumë shqiptarë të

Kosovës (11.2%) thanë se nuk e kanë ndonjë preferencë politike, krahasuar me pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (4%) dhe serbët e Kosovës (1.1%).




FIGURA 14 Gjasat që të anketuarit të votojnë dhe preferencat e votimit, të dhëna të zbërthyer sipas përkatësisë etnike

MJEDISI

Kur u pyetën për të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër, gjithsej 14.5% e të anketuarve pohuan se nuk kanë njohuri për këtë temë, dhe ky numër ka pësuar rënie që nga nëntori 2021 kur u shënuar në vlerën prej 27.5%, prilli 2022 me vlerën 18.5% dhe nëntorin 2022 me 19.6%. Gjithsej 38.3% thanë se kishin pak njohuri për këtë temë, ndjekur nga 32.3% që kishin njohuri mesatare për këtë temë dhe 14.9% që kishin shumë njohuri për këtë temë.




FIGURA 15 Vetëdijesimi i të anketuarve në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër

Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë dallime të konsiderueshme mes komuniteteve të ndryshme në Kosovë në lidhje me vetëdijesimin e tyre për të drejtën për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër. Gjithsej 31.5% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, 13.8% e serbëve të Kosovës dhe 14.7% e shqiptarëve të Kosovës deklaruan se nuk kanë njohuri për këtë çështje, çka tregon ulje të mungesës së njohurive krahasuar me nëntorin 2022 (46.5% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, 32.9% e serbëve të Kosovës dhe 18% e shqiptarëve të Kosovës). Shqiptarët e Kosovës përfaqësonin pjesën më të madhe të të anketuarve që pohuan se kishin shumë njohuri për këtë temë me 16.1%, ndërsa vetëm 5% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës dhe 4.3% e serbëve të Kosovës e pohuan të njëjtën gjë.




FIGURA 16 Vetëdijesimi i të anketuarve në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër, të dhëna të zbërthyera sipas përkatësisë etnike

Të anketuarit u pyetën edhe në lidhje me vetëdijesimin e tyre për kërcënimet e mundshme mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre. Ngjashëm me nëntorin 2022, gjithsej 18.8% e të anketuarve pohuan se nuk kanë njohuri për këtë temë. Teksa 41.6% e të anketuarve pohuan se kanë pak njohuri për këtë temë, 33% thanë se kanë njohuri mesatare dhe 13.6% se kanë shumë njohuri për këtë temë. Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë treguan se 13.4% e meshkujve dhe 15.5% e femrave nuk kanë njohuri për këtë temë, ndërsa 16% e femrave dhe 13.9% e meshkujve pohuan se kishin shumë njohuri për këtë temë.

Deri në çfarë mase jeni të vetëdijshëm për kërcënimet e mundshme mjedisore ndaj shëndeti tuaj/të familjes suaj?




FIGURA 17 Vetëdijesimi i të anketuarve për kërcënime potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre

Të dhënat e zërthyera sipas përkatësisë etnike treguan se ka dallime të dukshme ndërmjet komuniteteve kur pohojnë se nuk kanë njohuri për këtë temë (treguar në figurën 18). Teksa vetëm 18.4% e shqiptarëve të Kosovës pohuan se nuk kanë njohuri për kërcënime potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre, 22.9% e serbëve të Kosovës dhe 38.5% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës e pohojnë të njëjtën gjë. Po ashtu, një pjesë më e madhe e shqiptarëve të Kosovës (14.7%) pohuan se kishin shumë njohuri për këtë temë, krahasuar me serbët e Kosovës (3.3%) dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (3.5%).

Deri në çfarë mase jeni të vetëdijshëm për kërcënimet e mundshme mjedisore ndaj shëndeti tuaj/të familjes suaj?




FIGURA 18 Vetëdijesimi i të anketuarve për kërcënime potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre, të dhëna të zbërthyera sipas përkatësisë etnike

Që nga nëntori 2021, anketa e opinionit e Pulsit Publik i ka pyetur të anketuarit për vetëdijesimin e tyre për ndryshimet klimatike. Gjithsej 15.2% (16% në nëntor 2022, 18% në prill 2022 dhe 12.3% në nëntor 2021) e të anketuarve pohuan se Kosova është shumë e ndikuar nga klima, ndërsa 18.3% (21% në nëntor 2022, 19% në prill 2022, dhe 38% në nëntor 2021) e të anketuarve pohuan se Kosova është pak ose shumë pak e ndikuar nga ndryshimet klimatike. Gjithsej 66.4% pohuan se Kosova është deri diku e ndikuar nga ndryshimet klimatike, krahasuar me 61% në nëntor 2022, 16% në prill 2022 dhe 30.7% në nëntor 2021.

Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë nuk tregojnë dallime të konsiderueshme në opinionet e meshkujve dhe femrave në lidhje me ndikimin e ndryshimeve klimatike në Kosovë.

A mendoni se ndikohet Kosova nga ndryshimet klimatike?




FIGURA 19 Vetëdijesimi i të anketuarve për ndikimin e ndryshimeve klimatike në Kosovë

Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike treguan se 21.4% e serbëve të Kosovës, 13.7% e shqiptarëve të Kosovës dhe 8% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës besojnë se Kosova është shumë e ndikuar nga ndryshimet klimatike, ndërsa 81% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, 67% e shqiptarëve të Kosovës dhe 51% e serbëve të Kosovës besojnë se ndikohet deri diku.




FIGURA 20 Vetëdijesimi i të anketuarve për ndikimin e ndryshimeve klimatike në Kosovë, të dhëna të zbërthyera sipas përkatësisë etnike

DREJTËSIA TRANZICIONALE

Duke e marrë parasysh përvojën e gjatë të UNDP-së në punën për drejtësinë tranzicionale dhe qasjen e saj holistike për trajtimin e trashëgimive të konfliktit, forcimin e llogaridhënies, drejtësisë, kohezionit social dhe sundimit të ligjit, Puls i Publik e konsideroi drejtësinë tranzicionale si temë të rëndësishme që duhej të mbulohej nga edicioni i vet i ri. Të anketuarit u pyetën për opinionet e tyre për aspekte të ndryshme të drejtësisë tranzicionale. Gjithsej 44.2% e të anketuarve pohuan se trashëgimia e konfliktit dhe e shkuara kolektive e Kosovës nuk pasqyrohen profesionalisht në media, ndërsa 38.1% e të anketuarve pohuan se trashëgimia e konfliktit dhe e shkuara kolektive nuk pasqyrohen profesionalisht në media, dhe 17.8% pohuan se nuk e dinë ose refuzuan të përgjigjen. Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike treguan se një pjesë më e madhe e serbëve të Kosovës (52.4%) besonin se trashëgimia e konfliktit dhe e shkuara kolektive e Kosovës nuk pasqyrohen profesionalisht në media, krahasuar me 46% të shqiptarëve të Kosovës dhe 44% të pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës.




FIGURA 21 Opinioni i të anketuarve për pasqyrimin profesional nga media të trashëgimisë së konfliktit dhe të shkuarës kolektive të Kosovës.

Të anketuarve iu kërkua opinioni i tyre mbi “Marrëveshjen për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë” (marrëveshja). Gjetjet tregojnë se 58% e të anketuarve besojnë plotësisht ose besojnë se marrëveshja do të ndikojë pozitivisht në jetën e qytetarëve të Kosovës, ndërsa 30% pohuan se do të ndikojë deri diku, dhe 8.9% pohuan se nuk besojnë ose nuk besojnë aspak. Të dhënat e zërthyera sipas përkatësisë etnike treguan se 58.4% e shqiptarëve të Kosovës dhe 70% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës besonin plotësisht ose besonin se marrëveshja do të ndikojë pozitivisht në jetën e popullit të Kosovës, ndërsa 24.8% e serbëve të Kosovës e besonin të njëjtën gjë.




FIGURA 22 Perceptimi i të anketuarve për ndikimin tek populli i Kosovës nga Marrëveshja për Rrugën drejt Normalizimit të Marrëdhënieve.

Shumica e të anketuarve (57.1%) pohuan se besojnë plotësisht ose besojnë se marrëveshja do ta ndihmojë Kosovën në rrugën e saj drejt BE-së. Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike treguan se 58% e shqiptarëve të Kosovës dhe 64.2% besojnë ose besojnë plotësisht se marrëveshja do ta ndihmojë Kosovën në rrugën e saj drejt BE-së, ndërsa vetëm 21.6% e serbëve të Kosovës e besojnë të njëjtën gjë. Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë treguan se femrat (60%) janë më optimiste se marrëveshja do të ketë ndikim pozitiv tek populli i Kosovës, krahasuar me meshkujt (56%).

Gjithsej 38% e të anketuarve pohuan se besojnë se marrëveshja do të kontribuojë për paqen afatgjatë në Kosovë, 38.9% pohuan se do të kontribuojë deri diku, 16.1% se nuk do të kontribuojë, dhe 7.4% e të anketuarve nuk e dinin ose refuzuan të përgjigjen. Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike treguan dallime ndërmjet komuniteteve të ndryshme në lidhje me opinionin e tyre për ndikimin e marrëveshjes në paqen afatgjatë në Kosovë. Gjithsej 32% e shqiptarëve të Kosovës dhe 34% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës besonin se marrëveshja do të kontribuonte për paqen afatgjatë në Kosovë, ndërsa 6.2% e serbëve të Kosovës e besonin të njëjtën gjë. Gjithsej 50% e serbëve të Kosovës, 35.4% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës dhe 15% e shqiptarëve të Kosovës nuk janë optimistë se marrëveshja do të kontribuojë në paqen afatgjatë në Kosovë. Gjithsej 45.2% e shqiptarëve të Kosovës dhe 35.7% e serbëve të Kosovës besonin se marrëveshja do të kishte deri diku efekt pozitiv në paqen afatgjatë në Kosovë, ndërsa 26% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës e besonin të njëjtën gjë.

Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë treguan se femrat (41%) janë më pozitive sesa meshkujt (34.1%) se marrëveshja do të ketë efekt pozitiv në paqen afatgjatë në Kosovë. Rrjedhimisht, më shumë meshkuj (17%) besojnë se marrëveshja nuk do të ndikojë pozitivisht në paqen afatgjatë në Kosovë, krahasuar me femrat (15%). Gjithsej 41% e meshkujve dhe 37% e femrave besonin deri diku se marrëveshja do të ketë efekt pozitiv në paqen afatgjatë.




FIGURA 23 Perceptimi i të anketuarve rreth çështjes nëse Marrëveshja për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do ta forcojë kohezionin social në Kosovë, zbërthyer sipas gjinisë.

METODOLOGJIA

Gjetjet e paraqitura në këtë përmbledhje bazohen në anketën e opinionit me 1,306 të anketuar në Kosovë mbi moshën 18 vjeçare, të realizuar nga 5 deri më 25 prill 2023. Mostra përfshiu numër të njëjtë të meshkujve dhe femrave nga të gjitha komunat dhe rajonet e Kosovës, duke i mbuluar si zonat urbane ashtu edhe ato rurale. Në aspektin e përfaqësimit etnik, mostra i ka përfshirë 896 shqiptarë të Kosovës, 210 serbë të Kosovës dhe 200 pjesëtarë të komuniteteve të tjera të Kosovës (ashkali të Kosovës, boshnjak të Kosovës, egjiptas të Kosovës, goranë të Kosovës, romë të Kosovës, dhe turq të Kosovës) Anketa u bazua në marrjen e mostrave me probabilitet rastësor në etapa të shumëfishta, dhe u krye përmes intervistave sy më sy. Mostra është përfaqësuese e ekonomive familjare në Kosovë.³

PESHIMI/PONDERIMI I TOTALEVE TË POPULLATËS

Anketat e Pulsit Publik i marrin mostra më të mëdha të pakicave në mënyrë që të dhënat të mund të zbërthehen sipas përkatësisë etnike. Megjithatë, kur bëhen përlogaritjet për totalet, ekipi i Pulsit Publik e bën peshimin/ponderimin e të dhënave sipas shifrave aktuale të popullatës. Që nga viti 2002, janë përdorur përqindjet e mëposhtme për peshimin/ponderimin e totaleve të popullsisë:

- Shqiptarë të Kosovës: 88%;
- Serbë të Kosovës: 6%;
- Pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës: 6%.

³ Në raport përdoren termat përqindje dhe pikë përqindjeje. Një pikë përqindjeje është ndryshimi numerik mes dy përqindjeve; ndërsa përqindja është raporti i shprehur si fraksion i 100. Përqindja i referohet shkallës së ndryshimit, ndërsa pika e përqindjes e mat sasinë reale të ndryshimit.

Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 dhe të dhënave zyrtare nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, përbërja etnike aktuale në Kosovë është siç vijon:

Përkatësia etnike	Gjithsej popullsia	Përqindja e popullsisë totale
Shqiptarë të Kosovës	1,616,869	92.93
Serbë të Kosovës	25,532	1.47
Turq të Kosovës	18,738	1.08
Boshnjakë të Kosovës	27,533	1.58
Goranë të Kosovës	10,265	0.59
Romë të Kosovës	8,824	0.51
Ashkali të Kosovës	15,436	0.89
Egjiptas të Kosovës	11,524	0.66
Të tjerët, refuzuan të deklarojnë dhe nuk janë në dispozicion	5,104	0.29
Gjithsej	1,739,825	100.00

Nëse këto shifra do të ndiqeshin për Anketat e Pulsit Publik, peshimi/ponderimi do të ishte si më poshtë:

- Shqiptarë të Kosovës: 93%;
- Serbë të Kosovës: 2%;
- Pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës: 5%.

Megjithatë, marrë parasysh se serbët e Kosovës në pjesën veriore të Kosovës nuk morën pjesë në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011, së bashku me vlerësimin e përgjithshëm se shkalla e pjesëmarrjes së serbëve në pjesën tjetër të Kosovës është më e ulët, u vlerësua se duhet t'i shtojmë edhe 34,000 serbë të tjerë të Kosovës, duke e sjellë në 59,532 numrin total të serbëve të Kosovës të konsideruar për qëllimet e këtij studimi. Ky veprim gjithashtu e rriti popullsinë e përgjithshme të Kosovës në 1,773,825. Kur merren në konsideratë këto ndryshime, peshimi/ponderimi në anketat e Pulsit Publik është bërë si në vijim:

- të Kosovës: 92%;
- Serbë të Kosovës: 4%;
- Pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës: (ashkali të Kosovës, boshnjakë të Kosovës, egjiptas të Kosovës, goranë të Kosovës, romë të Kosovës, dhe turq të Kosovës): 4%.

PËRLLOGARITJA E INDEKSEVE

Indeksi i Demokratizimit (ID) është një mesatare e përbërë e bazuar në nivelin e pajtimit apo mospajtimit të të anketuarve me zhvillimet vijuese në Kosovo: shkalla e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, monitorimi i Kuvendit, performanca e institucioneve qendrore, pavarësia e sistemit gjyqësor, liria e shprehjes dhe mediave, ekzistenca e një shoqërie civile mbikëqyrëse në Kosovë, Kushtetuta dhe ligjet e bazuara në të drejtat e njeriut, dhe nëse institucionet lokale dhe ato ekzekutive qendrore punojnë në përputhje me prioritetet e qytetarëve. ID-ja është matje e vazhdueshme e cila shkon nga 0 në 3, ku rezultati prej 0 deri në 1.5 do të thotë që shumica e të anketuarve e konsiderojnë se demokratizimi nuk është në rrugën e duhur, kurse rezultati prej 1.5 deri në 3 do të thotë që shumica e të anketuarve pajtohen se demokratizimi është në rrugën e duhur.

Indeksi i Besueshmërisë Ekonomike (IBE) është një mesatare e përbërë e cila përllogaritet në bazë të vlerësimit të të anketuarve për kushte të favorshme ose të pafavorshme ekonomike në Kosovë. Konkretisht, të anketuarit i vlerësojnë kushtet në vijim: pritshmëritë në lidhje me të hyrat totale të familjeve të tyre, kushtet e punësimit për gjashtë muajt e ardhshëm, dhe vlerësimin e kushteve aktuale të biznesit dhe punësimit. IBE-ja është një matje e vazhdueshme me vlera që shkojnë nga 0 në 3, ku harku prej 0 deri në 1.5 tregon një vlerësim të pafavorshëm të gjendjes ekonomike nga shumica e popullatës, kurse harku prej 1.5 deri në 3 tregon një vlerësim të favorshëm nga shumica.

